

VENDIM
Nr. 381, datë 12.6.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KRITEREVE PËR
PËRZGJEDHJEN, KONTRAKTIMIN E PAGESËN E AVOKATËVE OSE ZYRAVE
TË AVOKATISË VENDASE OSE TË HUAJA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “c”, të nenit 7, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave dhe i kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin dhe pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja.

2. Procedura për kontraktimin dhe përzgjedhjen e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja do të kryhet në përputhje me parimin e konkurrencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë të ofertuesve, si dhe konfidencialitetit.

3. Institucioni i Avokaturës së Shtetit, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për personat juridikë publikë, të përcaktuar në nenin 5, pika 1/1, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, ose në raste të tjera në kuadër të ushtrimit të kompetencave për mbrojtjen e interesit pasuror të Republikës së Shqipërisë, përzgjedh dhe kontraktin avokatë ose zyra avokatie vendase ose të huaja.

4. Personat juridikë publikë, të përcaktuar në nenin 5, pika 1/1, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me kërkesë të motivuar, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duhet të parashtojnë nevojën për asistencë juridike. Në çdo rast, kërkesa, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duhet të përmbajë:

a) argumentimin e fakteve e të rrethanave që kanë çuar në këtë kërkesë, si dhe nevojën apo natyrën e asistencës juridike të kërkuar;

b) identifikimin, për aq sa është e mundur në këtë fazë të procesit, të çështjeve apo të detyrave konkrete, të cilat duhet të plotësohen nga avokati apo zyra e avokatisë vendase ose e huaj;

c) angazhimin dhe përshkrimin e masave, të cilat do të ndërmerren nga ana e personit juridik për përballimin e të gjitha shpenzimeve ekonomike, të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike.

5. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shprehet lidhur me kërkesën e paraqitur nga ana e personit juridik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e saj, duke arsyetuar vendimmarrjen e tij mbështetur në këto kriterë:

a) Çështja është me rëndësi të veçantë për interesat pasurorë të personit juridik apo të Republikës së Shqipërisë;

b) Çështja ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacion të caktuar;

c) Çështja ka si objekt dëmshpërblimin për shuma më të mëdha se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

ç) Në raste të tjera të veçanta të çmuara nga personi juridik ose Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

6. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr urdhrë për fillimin e procedurës së konkurrimit për përzgjedhjen dhe kontraktimin e avokatit ose të zyrës së avokatisë vendase ose të huaj, duke përcaktuar, në çdo rast:

a) nevojën për asistencë juridike dhe kontraktimin e avokatit ose të zyrës së avokatisë vendase ose të huaj;

b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) komisionin për hartimin e ftesës për ofertë dhe zhvillimin e procedurës së konkurrimit e të përzgjedhjes së ofertuesit.

7. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me përfaqësues të Avokaturës së Shtetit, ku njëri prej tyre është kryetari. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi e urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i dërgon me shkrim/elektronikisht ftesën për ofertë avokatit apo zyrove të avokatisë vendase apo të huaja që janë renditur në udhërrëfyes ndërkombëtarë të njohur në këtë fushë.

8. Komisioni publikon gjithashtu në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit njoftimin për nevojën për kontraktimin e avokatëve apo të zyrove të avokatisë. Njoftimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që u jep mundësi subjekteve të interesuara të shprehin interesin nëse do të marrin pjesë ose jo në këtë procedurë konkurrimi. Në vijim të shprehjes së interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi, komisioni i dërgon me shkrim/elektronikisht ftesën për ofertë subjektit të interesuar.

9. Afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 5 (pesë) ditë pune nga dita kur është shpallur njoftimi në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit. Megjithatë, në varësi të natyrës e të llojit të shërbimit, objekt i procedurës së konkurrimit, komisioni mund të caktojë një afat më të gjatë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

10. Ftesa për ofertë duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë subjekteve të interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre. Ky informacion duhet të përmbajë:

- a) një referencë për njoftimin e publikuar të procedurës së konkurrimit;
- b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;
- c) kriteret e kualifikimit që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë në kuadër të këtij procesi konkurrimi, si dhe kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës fituese;
- ç) vendin, datën dhe orën për dorëzimin e hapjen e ofertave;
- d) gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumentacionit shoqërues;
- dh) informacione të tjera që komisioni i vlerëson të nevojshme.

11. Subjektet e interesuara mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në ftesën për ofertë. Komisioni i jep këto sqarime dhe ua dërgon të gjitha subjekteve me shkrim/elektronikisht, të cilave u është dërguar ftesa për ofertë. Nëse është e nevojshme, komisioni zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertave.

12. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara në ftesën për ofertë përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe/ose administrativ të ofertuesve për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Për të marrë pjesë në një procedurë konkurrimi, ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) dokumentin që vërteton se ofertuesi është regjistruar në regjistrat përkatës profesionale dhe tregtarë të shtetit, në të cilin është themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tij ligjor;
- b) dokumentin që vërteton se ofertuesi nuk është në proces falimentimi apo kapitalet dhe asetet nuk janë në proces ekzekutimi nga ana e përbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdher sekuestroje për to;

c) dokumentin që vërteton se ofertuesi nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale që lidhen me aktivitetin e tij profesional;

ç) certifikatën ISO 27001 në emër të ofertuesit, që vërteton se ofertuesi aplikon standardet e sigurisë së informacionit, lëshuar nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar.

13. Kriteret për kualifikim janë të njëjta për çdo procedurë konkurrimi. Ofertuesi duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim të parashikuara në shkronjat "a", "b" e "c", të pikës 12, të këtij vendimi, me dokumente të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e hapjes së ofertave. Ofertuesit, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë këto dokumente, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit një vetëdeklaratë me shkrim.

14. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për shkualifikimin e ofertuesit.

15. Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës fituese janë të njëjta për çdo procedurë konkurrimi. Komisioni zbaton kriteret e vlerësimit me qëllim vlerësimin e ofertës nga pikëpamja ekonomiko-teknike, si:

- a) Oferta ekonomike;
- b) Përvoja profesionale e ofertuesit;
- c) Eksperienca të ngjashme të stafit kryesor të propozuar me natyrën e mosmarrëveshjes dhe/ose të shërbimit të kërkuar;
- ç) Raste të suksesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit.

16. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në adresën e përcaktuar në ftesën për ofertë, brenda afatit kohor, të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

17. Komisioni hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuara në ftesën për ofertë.

18. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune, verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së ofertuesit fitues në një procedurë konkurrimi, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e kualifikuar. Në të kundërt, komisioni anulon procedurën dhe fillon një procedurë të re konkurrimi.

19. Për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, komisioni, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim/elektronikisht për ofertat e tyre. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet apo të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

20. Komisioni mund të korrigjojë ato gabime në propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të propozimeve. Komisioni njofton menjëherë ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronikisht për çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që ofertuesi ta ketë miratuar këtë ndryshim. Nëse ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë propozimi do të refuzohet.

21. Komisioni vijon vlerësimin e propozimeve ekonomiko-teknike vetëm të ofertuesve të kualifikuar. Vlerësimi i propozimeve ekonomiko-teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret, si më poshtë vijon:

a) Oferta ekonomike, së cilës i bashkëlidhet një listë e detajuar çmimesh, ku do të pasqyrohen pagesat e shërbimit të konsulencës dhe shpenzimet e tjera, si: shpenzimet për udhëtime, për printimin e raporteve e shpenzime sekretarie. Ofertuesi duhet të dorëzojë çmimin total të propozimit pa TVSH-në, si dhe vlerën e TVSH-së si zë më vete, nëse është e aplikueshme. Të gjitha çmimet e propozuara duhet të jenë fikse dhe jo objekt rishikimi. Propozimit me çmimin më të ulët i jepet vlerësimi maksimal prej 40 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepen vlerësime, ku çmimet e tyre janë në përpjesëtim të zhdrejtë me çmimin më të ulët, sipas formulës: Pikët për propozimin ekonomik = $40 \times \frac{\text{çmimi më i ulët}}{\text{çmimi ofertuesi}}$.

b) Përvoja profesionale e ofertuesit. Për vlerësimin e këtij kriteri, në rastin e përfaqësimit ligjor, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve, ku ofertuesi është angazhuar përpara dhomës përkatëse të arbitrazhit, ndërsa në rastet e kontratave me objekt dhënien e asistencës juridike, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve, ku ofertuesi ka realizuar shërbime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit. Propozimit me numrin më të madh të rasteve i jepet vlerësimi maksimal prej 20 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepet vlerësim, ku numri i rasteve të paraqitura është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin më të madh, sipas formulës: Pikët për përvojën profesionale = $20 \times \frac{\text{numri i rasteve}}{\text{numri i ofertuesit}}$.

c) Eksperienca të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit që do të angazhohen në realizimin e objektit të kontratës. Për vlerësimin e këtij kriteri do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve me natyrë të ngjashme me objektin e mosmarrëveshjes dhe/ose shërbimit të kërkuar në të cilat

stafi është angazhuar. Propozimit me numrin më të madh të rasteve i jepet vlerësimi maksimal prej 20 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepet vlerësim, ku numri i rasteve të paraqitura është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin më të madh, sipas formulës: Pikët për eksperiencë të ngjashme = $20X$ numrin e propozimit të radhës/numrin më të madh të rasteve.

c) Raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit. Për vlerësimin e këtij kriteri do të shërbejë numri i përfaqësimeve ligjore / i dhënies së asistencës juridike për procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit. Propozimit me numrin më të madh të rasteve i jepet vlerësimi maksimal prej 20 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u jepet vlerësim, ku numri i rasteve të paraqitura është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin më të madh, sipas formulës: Pikët për raste suksesi = $20X$ numrin e propozimit të radhës/numrin më të madh të rasteve.

22. Çdo kriter vlerësohet sipas metodës së vlerësimit të parashikuar në pikën 21, të këtij vendimi, dhe, më pas, pesha e tij kthehet në pikë përkatëse. Oferta ekonomikisht më e favorshme do të jetë oferta, e cila ka siguruar shumën më të madhe totale të pikëve të propozimit ekonomik dhe të propozimit teknik. Ofertuesi që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve të propozimit ekonomik dhe propozimit teknik do të renditet i pari dhe, në vijim, ofertuesit e tjerë, sipas pikëve të siguruara.

23. Komisioni, gjatë shqyrtimit të ofertave, duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit të ofertuesve, si më poshtë vijon:

a) Konfliktin ndërmjet ofertuesve. Ofertuesit nuk mund të konkurrojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një ofertuesi duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për ofertuesin dhe mosangazhimin në stafin e ofertuesve të tjerë, kandidatë në të njëjtën procedurë konkurrimi;

b) Konfliktin ndërmjet objektit të procedurës së konkurrimit ose llojit të shërbimit të kërkuar. As ofertuesi dhe as ndonjëri prej anëtarëve të stafit të tyre nuk duhet të ofrojnë konsulencë për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me objektin e procedurës së konkurrimit ose llojin e shërbimit të kërkuar;

c) Marrëdhënien me stafin e Avokaturës së Shtetit ose personit juridik. Ofertuesit, përfshirë stafin e tyre, nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit në raport me anëtarët e komisionit apo zyrtarët e tjerë të përfshirë në këtë procedurë konkurrimi.

Për këtë qëllim, ofertuesi, stafi i tij, si dhe zyrtarët e përfshirë në një procedurë konkurrimi nënshkruajnë një deklaratë me anë të së cilës deklarojnë se nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit.

24. Në çdo rast, komisioni duhet të argumentojë e të dokumentojë lidhur me mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe mënyrën e pikëzimit, sipas kriterëve të këtij vendimi. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

25. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave komisioni njofton me shkrim/elektronikisht individualisht secilin ofertues lidhur me vlerësimin e ofertës së tij. Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin dhe renditjen e ofertave apo rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

26. Çdo ofertues mund të paraqesë ankesë me shkrim/elektronikisht brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga marrja e njoftimit pranë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Me marrjen e ankesës me shkrim/elektronikisht nga ofertuesi, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit urdhëron komisionin të pezullojë vazhdimin e procedurës së konkurrimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shqyrton ankesën e paraqitur brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes së saj.

27. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me urdhër, ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim lidhur me këtë ankesë. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet

të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Vendimi i komisionit, nëpërmjet Avokatit të Përgjithshëm, i njoftohet komisionit të përzgjedhjes.

28. Komisioni, pas përfundimit të procedurave dhe të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën:

- a) referencën për njoftimin e publikuar të procedurës së konkurrimit;
- b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;
- c) ofertuesit e shkualifikuar dhe arsyet e shkualifikimit;
- ç) ofertuesit e kualifikuar dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave;
- d) renditjen e ofertuesve dhe informacion, nëse ka pasur ankesa lidhur me to.

29. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së ofertuesit, institucioni i Avokaturës së Shtetit fton ofertuesin e përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës. Kur ofertuesi i suksesshëm nuk arrin të nënshkruajë kontratën, institucioni fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve.

30. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit autorizon një avokat shteti për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me avokatin ose zyrën e avokatisë së përzgjedhur, si dhe personin juridik përkatës. Pas lidhjes së kontratës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit merr masa për të pajisur avokatin ose zyrën e avokatisë së përzgjedhur me autorizimin përkatës.

31. Në të njëjtën kohë, titullari i personit juridik autorizon një nëpunës të nivelit të lartë drejtues për ndjekjen e çështjes, deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me Avokaturën e Shtetit e me subjektin e përzgjedhur.

32. Krerët III e IV, të vendimit nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””, shfuqizohen.

33. Ngarkohet Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe